



# MONITORIMI I TË DREJTËS PËR INFORMIM

MANUAL

TRANSPARENCA PROAKTIVE DHE REAKTIVE



*Projekte Vullnetare Ndërkombëtare*



TIRANË, 2021

Ky manual u ndërtua nga Projekte Vullnetare Ndërkombëtare në kuadër të projektit “Organizatrat Rinore, Media dhe Të Rinjtë për Monitorim Qytetar” i cili zbatohet me mbështetjen financiare të National Endowment for Democracy.



## Përmbajtja

Hyrje.....	4
1. Rëndësia e të drejtës për informim në nivel vendor.....	4
2 Roli i OSHC-ve në promovimin e të drejtës për informim .....	5
Kuadri ligjor që rregullon të drejtën për informim .....	8
1. Informimi me kërkesë .....	9
1.1 Si mund të bëjmë një kërkesë për informacion? .....	10
1.2 Kush është Koordinatori për të Drejtën e Informimit? .....	11
1.3 A duhet të paguaj për të marrë informacionin e kërkuar? .....	11
1.4 Cilat janë afatet e kthimit të përgjigjeve mbi kërkesën për informim? .....	13
1.5 Kur kufizohet e drejta për informim? .....	13
1.6 Si të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale? .....	15
1.7 Çfarë vendos Komisioneri pas vlerësimit të ankesës suaj? .....	15
2.0 . INFORMIMI PA KËRKESË: Programi i Transparencës .....	18
2.1 Kategoritë e Informacionit në Programin e Transparencës.....	21
2.2 Procesi i përgatitjes dhe zbatimit të programit të transparencës .....	22
3. Strukturat për Informacion dhe Monitorim mbi të drejtën për informim .....	24
3.1 Instrumenti i Vlerësimit së Transparencës Proaktive dhe Reaktive.....	25
3.2 Një sistem i tillë i shërben të gjithë aktorëve, duke filluar nga: .....	26
3.3 VLERËSIMI PROAKTIV .....	27
3.3.1 Programi i Transparencës .....	27
3.3.2 Transparenca online- website, media sociale.....	27
3.3.2 Vlerësimit së Transparencës Proaktive përmes publikimit të informacionit në standën e bashkive .....	27
3.3.4 Vlerësimi i Transparencës reaktive përmes kërkesave për informim .....	28
INSTRUMENTI I VLERËSIMIT SË TRANSPARENCËS PROAKTIVE DHE REAKTIVE.....	29

## Hyrje

Informimi dhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve në proceset vendimmarrës janë mekanizma që pasqyrojnë nivelin e demokratizimit të një vendi. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve. E drejta për informim është një e drejtë themelore në një shoqëri demokratike. Liria e informimit është pjesë përbërëse e lirisë së fjalës në të drejtën ndërkombëtare, e cila është sot përkufizohet si “liria e shprehjes”.

Republika e Shqipërisë ofron garanci të plota ligjore dhe kushtetuese për të drejtën e informimit. Shqipëria hyn ndër ato pak vende të cilat e kanë ngritur në nivelin e normës kushtetuese këtë të drejtë. Në vitin 2014 Shqipëria përmirësoi dukshëm kuadrin ligjor për të drejtën e informimit duke adoptuar ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”<sup>2</sup>. Ky hap u ndërmor edhe si një kërkesë konstante e shoqërisë civile shqiptare.

Në këtë frymë, miratimi i ligjit Nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit” është një hap i rëndësishëm për një qeverisje të hapur dhe gjithëpërfshirëse. Miratimi i ligjit ishte një hap i rëndësishëm për garantimin e kësaj të drejte për qytetarët, pa u kushtëzuar në motivimin apo arsyetimin e qëllimit të kërkesës së tyre. Ligji ka për qëllim të nxisë përfundimisht integritetin, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër joshitetëror që ushtron funksione publike. Informimi i publikut është një element kyç i qeverisjes me pjesëmarrje.

### **Qëllimi i së drejtës për informim:**

- Garantimi i njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë;
- Garantimi i formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë;
- Nxitja e integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë të autoriteteve publike.

### ***1. Rëndësia e të drejtës për informim në nivel vendor***

E drejta e aksesit në informacion publik përmirëson transparencën dhe llogaridhënien në nivelin e vetëqeverisjes vendore. Rritja e qëndrueshmërisë së luftës kundër korrupsionit dhe fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë vendore, sigurohet përmes mekanizmave që garantojnë informimin dhe pjesëmarrjen në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma përmirësojnë proceset demokratike, rrisin eficiencën e shërbimeve dhe forcojnë besimin që qytetarët kanë në qeverisje. Në nivelin vendor, informimi publik konsiderohet si baza e ndërveprimit dhe çelësi i marrëdhënieve të besueshme midis komunitetit dhe qeverisjes vendore.

## **Organet e njësive të qeverisjes vendore si autoritete publike mbartin detyrimin e garantimit të së drejtës për informim si detyrim kushtetues dhe ligjor për të siguruar transparencën e veprimitarisë së tyre.**

Bashkitë, si niveli i qeverisjes më pranë qytetarëve dhe si ofrues të shërbimeve publike në nivel vendor, kanë një rol të rëndësishëm në informimin publik dhe vendimmarrjen vendore me pjesëmarrje. Ndërveprimi me qytetarët dhe procesi i krijimit të besimit kushtëzohen nga transparenca dhe llogaridhënia.

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime të rëndësishme të qeverisjes së mirë vendore.

- Transparenca – publikimi i informacionit procedural dhe përmbajtësor i shërbimeve publike në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe gjerësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë duke respektuar kufizimet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë. Transparenca e institucioneve publike vendore është baza për të rritur përgjegjshmërinë e këtyre institucioneve ndaj qytetarëve.
- Llogaridhënia- përgjegjshmëria e zyrtarëve publikë dhe atyre që ndikojnë këta të fundit në vendimmarrje, për veprimet e kryera në përputhje me procedurat ligjore. Ndryshe, parimi i llogaridhënies në këndvështrimin institucional njihet si “kontrollo dhe balanco”.
- Të dy parimet janë të lidhura me njëra-tjetrën, ku transparenca e autoriteteve të qeverisjes vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së të zgjedhurve vendorë dhe ndërtimit të besimit me publikun.

Kjo transparencë publike dhe llogaridhënie do të rrisë angazhimin dhe besimin qytetar në qeverisjen lokale. Pavarësisht progresit në kuadrin ligjor dhe rregullator për fushën e transparencës dhe llogaridhënies, zbatimi efektiv i këtij kuadri, kryesisht në nivelin vendor përbën ende një sfidë. Qytetarët dhe veçanërisht grupet më të marginalizuara kanë në përgjithësi njohuri më të kufizuara, për sa i përket ligjit për të drejtën e informimit dhe si rrjedhojë, nuk e ushtrojnë siç duhet këtë të drejtë.

## **2 Roli i OSHC-ve në promovimin e të drejtës për informim**

OSHC-të luajnë një rol kryesor në nxitjen e angazhimit qytetar dhe mbrojtjen e interesave të grupeve që punojnë apo përfaqësojnë. Përmes OSHC-ve qytetarët identifikojnë interesat e përbashkëta dhe duke marrë shkas nga kjo gjë, ndërmarrin veprime kolektive në dobi të përmirësimit të cilësisë së jetës së tyre. OSHC-të duhet të luajnë një rol më proaktiv për të mundësuar një lidhje më të drejtpërdrejtë dhe dinamike midis kërkesave të qytetarëve dhe përgjegjshmërisë vendore. Roli që OSHC-të kanë si mobilizues social midis komunitetit dhe institucioneve vendor, është instrumental në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies publike. OSHC-të mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në promovimin dhe ndërgjegjësimin

publik rreth ligjit për të drejtën e informimit dhe mënyrën se si qytetarët duhet të ushtrojnë këtë të drejtë.

Megjithatë, platformat e dëritanishme të informimit dhe bashkëpunimit nuk rezultojnë të jenë mjaftueshëm efektive. Përpos përpjekjeve të përbashkëta, për rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve publik dhe civil në lidhje me Programin e Transparencës, nevojitet një ndjeshmëri më e lartë civile për të nxitur me tej parimin “kontroll dhe balancë”.

Ndërmarrja e nismave të përbashkëta, për rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve publik dhe civil në lidhje me transparencën, është e rëndësishme për të siguruar një vetëdije më të lartë qytetare në ushtrimin e një nga të drejtave themelore të njeriut, siç është ajo e së drejtës për informim. Në mënyrë që të adresojmë këto sfida, është prioritarë hartimi i mekanizmave monitorues të transparencës dhe ngritja e kapaciteteve të shoqërisë civile mbi zbatimin e tyre. Nisma të tilla sigurojnë që procesi i informimit dhe konsultimit të jetë sa më transparent, efektiv dhe gjithëpërfshirës.

Padyshim që pjesëmarrja e OSHC-ve është e prioritarë për sa i përket nxitjes së aktivizimit dhe ndërgjegjësimit të grupeve të interesit për njohjen dhe ushtrimin e të drejtës për informim, njoftimin dhe konsultimin publik në qeverisjen vendore. Një nga objektivat kryesor të kësaj nisme është të kontribuojë në parandalimin e korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore në Shqipëri, përmes përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies vendore. Në këtë aspekt, projekti “Organizatrat Rinore, Media dhe të Rinjtë për Monitorimin e Transparencës dhe Llogaridhënies në Pushtetin Lokal” synon të forcojë kapacitetet e OShC-ve rinore dhe aktorëve të tjerë civilë për të monitoruar në mënyrë objektive zbatueshmërinë e detyrimeve që rrjedhin nga ligji Nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit” në lidhje me transparencën proaktive dhe reaktive të institucioneve në nivel vendore, duke u fokusuar në nismat, projektet dhe OSHC-të. Më konkretisht, përmes kësaj ndërhyrje, PVN do të asistoj teknikisht duke rritur kapacitetet e 14 organizatave të Shoqërisë Civile, me qëllim që këto OSHC të advokojnë në mënyrë efektive për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë në vendimmarrjen vendore.

Për këtë qëllim, ky manual ka për qëllim t’u vijë në ndihmë OSHC-ve vendore, gazetarëve, aktivistëve të shoqërisë civile, si dhe çdo qytetari të thjeshtë që ka nevojë për informacion nga autoritetet publike. Me qëllim që manuali të jetë sa më i thjeshtë dhe i kuptueshëm për qytetarët, ai është konceptuar në formatin më praktikm, cka lehtëson që OSHC-të të informohen në lidhje me ushtrimin e të drejtës së informimit.

Në përpjekje të përbashkëta për të promovuar një kulturë transformuese në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies vendore, PVN ka hartuar një instrumentin vlerësues të transparencës proaktive dhe reaktive në lidhje me nismat, projektet dhe të dhënat për OSHC-të në nivel vendor.

**Target grupi kryesor** i përdoruesve të këtij udhëzuesi përfshin përfaqësuesit e OSHC-ve dhe mediave vendore. Më tej udhëzuesi shërben si një instrument bazë për të gjithë aktorët e

shoqërisë civile qytetare për realizmin e procesit të monitorimit të transparencës dhe llogaridhënies në 61 bashkitë e vendit

# Kuadri ligjor që rregullon të drejtën për informim

Transparenca dhe e drejta për informim për njësitë e vetëqeverisjes vendore garantohen dhe janë të parashikuara në disa akte ligjore.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njofimit të informacionit dhe ideven me çfarëdo mjeti qofë, pa marrë parasysh kufjtë

DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT, Neni 19

Liritë dhe të Drejtat Vetjake

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

KUSHTETUTA e Republikës së Shqipërisë, Kreu II Liritë dhe Të Drejtat

LIGJI Nr. 119/2014  
"Për të drejtën e informimit", Kreu II

LIGJI Nr. 139/2015  
'Për Vetëqeverisjen  
Vendore'

E drejta e informimit

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nnëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Transparenca e veprimtarisë së njësisë të vetëqeverisjes Vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.
2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afshohet në vendet e caktuara nga njësia për njofimet publike.
3. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.



## 1. Informimi me kërkesë

Ligji e grupon informacionin në dy kategori të mëdha:

- Informacioni i bërë publik me kërkesë – ka të bëjë me atë kategori informacioni që kërkohet nga qytetarët nëpërmjet një kërkesë zyrtare;
- Informacioni i bërë publik pa kërkesë – ka të bëjë me informacionin që institucionet janë të detyruara të publikojnë



### Çfarë informacioni kam të drejtë të kërkoj?

Çdo qytetar ka të drejtë të kërkojë atë që quhet informacion publik. Sipas përkufizimit të ligjit, ky lloj informacioni përfshin çdo të dhënë të regjistruar nga institucionet publike në çfarëdo lloj forme e formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht se kush ka qenë autoriteti që e ka përpiluar atë.

E drejta qytetarëve të kërkojnë informacion pa shpjeguar motivet e kërkesës dhe detyrimi i institucioneve publike për të përmbushur këtë të drejtë duke respektuar kufizimet e të drejtës së informimit.

### Subjektet që kanë të drejtë të informohen:

Si çdo e drejtë e njeriut, e drejta për informimin u përket të gjithëve. Kjo përfshin personat fizikë (shtetas shqiptarë, të huaj, si dhe pa shtetësi), personat juridikë, organizata jo-qeveritare (OJQ) dhe përfaqësuesit ligjore të personave fizikë ose juridikë.

### Përkufizimi i "informacionit publik":

"Informacion publik" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Kjo do të thotë se autoriteti publik është i detyruar të japë informacion dhe dokumentacion, qofshin këto dokumente shkresorë ose audiovizualë, apo çdo lloj tjetër.

Dokumentet mund të ndahen në tre kategori:

- Dokumente të krijuara nga vetë autoriteti
- Dokumente të ardhura prej një autoriteti tjetër
- Dokumente të ardhura prej subjekteve private

**Në kategorinë e parë** përfshihen të gjitha dokumentat që krijohen nga vetë autoriteti, sic janë vendimet, rregulloret, udhëzimet, urdhërat, kontratat, memot, shkresat përcjellëse, dhe çdo dokument tjetër që i shërben komunikimit normal midis njësive të brendshme të strukturës së autoritetit publik.

**Në kategorinë e dytë** përfshihen dokumentet që kanë ardhur nga një autoritet tjetër publik, sic janë informacionet, urdhërat, raportet, vendimet dhe çdo dokument tjetër që i shërben komunikimit midis dy autoriteteve të ndryshme, pavarësisht raportit të hierarkisë midis tyre.

**Në kategorinë e tretë** përfshihen dokumentat që janë prodhuar dhe dorëzuar nga persona privatë. Këto dokumenta mund të jenë të prodhuara prej një autoriteti publik (p.sh. certifikata, vërtetime) ose mund të jenë të prodhuara nga vetë personi privat (p.sh. ofertë, deklaratë, etj).

### 1.1 Si mund të bëjmë një kërkesë për informacion?



Përpara se të bëni një kërkesë për informacion, është e këshillueshme që, nëse keni mundësi, të kontrolloni faqen online të institucionit për të cilin jeni të interesuar.

1. Kliko faqen zyrtare të bashkisë dhe verifiko nëse informacioni që kërkon nuk është i shpallur në faqen e internetit apo në Programin e Transparencës.

2. Nëse informacioni nuk është në programin e transparencës, gjeni të dhënat e koordinаторit për të drejtën e Informimit në

faqen e internetit të institucioni.

3. Shkarkoni formularin e kërkesës për informacion në faqen e internetit të institucionit dhe i bëni një kërkesë me shkrim koordinatorit për të drejtën e informimit.

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet :

- **Dorazi:** Duke ruajtur numrin e protokollit
- **Nëpërmjet shërbimit postar:** Ruaj kuponin postar
- **Nëpërmjet e-mailit:** Ruaj e-mailin e dërguar me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkesit dhe nënshkrimin e tij.

## 1.2 Kush është Koordinatori për të Drejtën e Informimit?



Koordinatori i të Drejtës për Informim është personi kryesor te i cili publiku duhet të drejtohet për kërkesat për informim. Koordinatori është personi i ngarkuar me këtë detyrë nga autoriteti publik, i cili ka për qëllim të bashkërendojë punën për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Më konkretisht, detyrat e Koordinatorit janë si më poshtë:

1. Pranon kërkesat për informim që i vijnë nga kërkues të ndryshëm, siguron numrin rendor për çdo kërkesë dhe u krijon mundësinë qytetarëve që, në përputhje me ligjin, të marrin informacionin e kërkuar.
2. Koordinatori krijon Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve dhe e përditëson atë sipas afateve ligjore, si për kërkesat e marra dhe për përgjigjet e dhëna.
3. Ai është bashkërenduesi i punës për plotësimin e kërkesave për informacion, ai qëndron midis kërkuesit dhe administratës së autoritetit publik dhe ndjek në mënyrë periodike ecurinë e kërkesës.
4. Në rastet kur autoriteti publik nuk e disponon informacionin e kërkuar, Koordinatori në respekt të afateve kohore e përcjell këtë kërkesë tek autoriteti kompetent që e disponon dhe njëkohësisht njofton edhe kërkuesin.
5. Ndjek të gjitha procedurat e nevojshme për vjeljen e pagesave për shërbimin e informimit, si dhe rastet kur është falas.
6. Kryen njoftimet paraprake e nevojshme në procedurën e zbatimit të ligjit.
7. Komunikon me kërkuesin për çdo rast dhe nevojë që ka në lidhje me plotësimin e saktë dhe të plotë të kërkesës për informim.

## 1.3 A duhet të paguaj për të marrë informacionin e kërkuar?

Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Të vetmet raste kur qytetarët mund të duhet të paguajnë një tarifë, është kur dhënia e informacionit mbart ***një kosto riprodhimi, ose një kosto dërgimi***, në rast se informacioni kërkohet me postë. Në rastet kur informacioni kërkohet në mënyrë elektronike, dhënia e informacionit nuk ka asnjë kosto. Gjithsesi, çdo tarifë duhet të jetë e përcaktuar qartë më parë nga autoriteti publik dhe të jetë afishuar në ambientet e institucionit. Po kështu, kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit dhe e njëjta gjë vlen dhe për koston e dërgimit, e cila nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e shërbimit në treg. Në rastet kur autoriteti publik mund të konstatojë se trajtimi i një kërkesë

për informim ka kosto të lartë, Koordinatori për Informim njofton menjëherë kërkuesin dhe propozon mundësinë e ndryshimit të kërkesës së tij, për shembull duke mundësuar dërgimin elektronik të materialit të kërkuar, gjë e cila nuk ka kosto.

**KËRKESË PËR INFORMACION**

Emër Mbiemër: Z./Znj. _____	Adresa postare: _____ Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____	Data: __/__/201__ Nënshkrimi: _____
--------------------------------	--	--

*(dërgimi i kërkesës elektronike kërkon emër, mbiemër)*

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: _____
--

Vetëm për përdorim zyrtar		
Data e marrjes: __/__/201__	Numri rendor i kërkesës: _____	Komente: _____

Informacioni në këtë format do të përpunohet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
---

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit [unik.pyetshetit.al](http://unik.pyetshetit.al) apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit dhe në portalin [pyetshetit.al](http://pyetshetit.al).
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

#### 1.4 Cilat janë afatet e kthimit të përgjigjeve mbi kërkesën për informim?



Afatet e kthimit të përgjigjeve mbi kërkesën për informim, sipas Ligjit, janë për sa vijon:

- jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të kërkesës, autoriteti publik duhet ta trajtojë, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur;
  - jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë, kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër;
- të dyja këto afate mund të zgjaten me jo më shumë se 5 ditë pune, për një nga shkaqet e mëposhtme:
    - a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;
    - b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;
    - c) nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim nga nëpunësi civil brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.



#### 1.5 Kur kufizohet e drejta për informim?

##### Rastet e kufizimit të kërkesës për informacion:

Ligji për të Drejtën e Informimit parashikon se e drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:

- a) të drejtën për një jetë private;
- b) sekretin tregtar;
- c) të drejtën e autorit;
- ç) patentat.

Po kështu e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit *shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë* ndaj interesave të mëposhtëm:

- a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;
- b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
- c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;

- d) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;
- e) formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit;
- f) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor;
- g) këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike;
- h) mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare.



Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilit argument ligjor është bërë refuzimi.

Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik. Autoriteti publik bën të mundur që informacioni, i cili i është dhënë të paktën një herë një kërkuar, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen.

**Ankimimi nëse nuk na japin informacionin që kërkon**



Qytetarët kanë të drejtë të ankohen edhe në rastet kur i refuzohet përgjigja, si dhe në rastet kur nuk merr informacionin që kërkon. Në këto raste, qytetari duhet të bëjë ankesë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**Ankimi bëhet në rastet kur bashkia:**

- Refuzon dhënien e informacionit/ nuk përgjigjet
- Kthen përgjigje pa vënë në dispozicion dokumentin e kërkuar
- Kthen përgjigje të paplotë

**1.6 Si të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale?**

Shkarkoni formatin e ankesës në faqen e internetit të institucionit, bëni një ankesë me shkrim dhe dërgojeni pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me: a) e- mail; b) dorazi c) postë.

Ankimimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve nga ;

- 1) Data kur ankuesi ka marrë njoftimin dhe refuzimin e informacionit
- 2) Data e kalimit të afatit për dhënien e informacionit e parashikuar në ligjin për të drejtën e Informimit

Komisioneri merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita e dorëzimit të saj. Mosrespektimi i dispozitave të Ligjit për të drejtën e Informimit, sjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në nenin 18 të Ligjit.

**1.7 Çfarë vendos Komisioneri pas vlerësimit të ankesës suaj?**

- a. Pranimin e kërkesës dhe urdhërimin e institucionit për të dhënë informacionin e kërkuar ose ndëshkon me gjobë kundër titullarit që ka penguar dhënien e informacionit.
- b. Mospranimin e kërkesës kur nuk është respektuar afati ose forma e paraqitjes
- c. Rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht.

**Kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë ta ankimojë vendimin e Komisionerit në gjykatën administrative kompetente.**

**Në bazë të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”**

<b>Emri / Mbiemri<sup>1</sup> :</b>
<b>Adresa:</b>
<b>Qyteti :</b>
<b>Telefon:</b>
<b>E-mail:</b>

<b>Autoriteti Publik :</b>
<b>Adresa:</b>
<b>Qyteti:</b>

*Identifikoni saktë Autoritetin Publik/Institucionin ndaj të cilit ankoheni.*

Përshtuani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga Autoriteti Publik dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhni ato.

---



---



---



---



---



---

Përshtuani çfarë kërkoni nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.119/2014.

---



---

(Data) \_\_\_\_\_

(Firma) \_\_\_\_\_

*Formulari i ankesës duhet të shoqërohet me formularin e kërkesës për informim drejtuar Autoritetit publik si dhe recetën postare ose emailin drejtuar Autoritetit Publik.*

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për sqarime më të detajuara kontaktoni KDIMDP ose koordinatoren e të drejtës për informim.

<sup>1</sup> Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuarit.



**A ka sanksione kundër autoriteteve publike që shkelin ligjin për të drejtën e informimit?**

Ligji parashikon se moszbatimi i dispozitave të tij konsiderohet kundërvajtje administrative. Në rastet kur Komisioneri konstaton shkelje të së drejtës për informim, atëherë vendosen gjoba të drejtpërdrejta ndaj titullarit të institucionit, koordinatorit të së drejtës së informimit apo për çdo nëpunës përgjegjës për mosdhënie informacioni.

## 2.0 . INFORMIMI PA KËRKESË: Programi i Transparencës



Ligji 119/2014 detyron autoritetet publike për të përgatitur, publikuar dhe përditësuar programin e transparencës duke synuar rritjen e aksesit në informacione zyrtare. Qasja proaktive në informacionin zyrtar përmes përdorimit të faqeve zyrtare të internetit mundëson akses maksimal, në njëjtën kohë, për numër të papërcaktuar subjektësh apo qytetarësh. Kjo lehtëson barrën e sporteve, shkurton rradhët dhe rrit efikasitetin e administratës.

Institucionet publike duhet të jenë të detyruara të publikojnë në mënyrë proaktive informacionet e rëndësishme për publikun, pa detyruar këtë të fundit të bëjë kërkesa për informacion. Të gjitha institucionet publike duhet të publikojnë informacione për veprimtarinë e tyre, buxhetin, auditimet, prokurimet publike, vendimmarrjet etj. sikurse e kërkon ligji mbi të drejtën e informimit.

Në nenin 7 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” janë parashikuar të gjitha kategoritë e informacionit që duhet të përmbajë programi i transparencës, ndërsa në nenin 6 është parashikuar që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Komisioneri) miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike. Komisioneri, me Urdhrin Nr. 211, datë 10.09.2018, miratoi programin model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky program transparence i dedikuar për njësitë e qeverisjes vendore u hartua nga IDM-ja në kuadër të projektit STAR2, dhe për të garantuar transparencë maksimale ka marrë në konsideratë jo vetëm Kushtetutën dhe Ligjin 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, por edhe ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligjin Nr.

68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si edhe ligjin Nr. 8548, datë 11.11.1999 Për Ratifikimin e “Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Referuar urdhërit të Komsionerit, duhej që bashkitë të kishin hartuar dhe miratuar programin e ri të transparencës brenda datës 1 janar 2019. Informacioni i publikuar pa kërkesë, apo siç njihet ndryshe transparencë proaktive, duhet të jetë në përputhje me parimet e mëposhtme:

**Të jetë i aksesueshëm për të gjithë qytetarët** informacioni që ka të bëjë me veprimtarinë e institucionit, duke filluar me buxhetin, informacione mbi prokurimet publike, kuadrin ligjor ose rregullator, kontratat e koncesioneve, CV-të e punonjësve dhe subjektet që deklarojnë pasuritë e tyre, organigramën etj.

**Ligjshmëria, transparenca dhe antidiskriminimi.** Aksesi në informacion duhet të sigurohet në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor në fuqi, por duke i dhënë përparësi ligjit për të drejtën e informimit.

**Ofrimi i informacionit falas.** Tarifat e vendosura për vënien në dispozicion të informacionit publik konsiderohen si një pengesë për të aksesuar informacion publik. Për këtë arsye, transparenca proaktive mundëson që një pjesë e madhe e informacioni të bëhet publik në faqet e internetit, duke siguruar kështu akses falas për të gjithë qytetarët. Ndërsa në rastet kur informacioni i kërkuar është voluminoz, duhet të ofrohet kundrejt një tarife të përcaktuar.

**Akses për këdo.** Aksesi në informacion duhet t'u ofrohet të gjithëve, duke i dhënë gjithashtu një fokus të veçantë grupeve më të prekura të shoqërisë dhe shtresave në nevojë (të varfërve, të papunëve, personave të marginalizuar, personave me aftësi të kufizuara, si dhe minoriteteve).

Është shumë e rëndësishme që informacioni i vënë në dispozicion të qytetarëve të jetë:


- ✓ i plotë,
- ✓ i saktë;
- ✓ i përditësuar;
- ✓ i lehtë për t'u shqyrtuar;
- ✓ i kuptueshëm;
- ✓ lehtësisht i aksesueshëm;
- ✓ në përputhje me dokumentet origjinale të institucionit përkatës;
- ✓ lehtësisht i përdorshëm.
- ✓

**PT përmban kategoritë e informacionit që duhet të bëhen publike pa kërkesë, të grupuara në 7 fusha si më poshtë:**

- 1.Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë
- 2.Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare
- 3.Për kërkesat për informim
- 4.Shërbime publike
5. Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore
6. Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje
- 7.Informacion tjetër

Për secilën prej fushave të mësipërme është detajuar lista e dokumenteve, si dhe baza ligjore e rregullatore përkatëse. Në mënyrë të detajuar lista e dokumentacionit që duhet të publikohet në programin e transparencës, gjendet në Aneksin I. Duhet theksuar se programi i transparencës mund të rishikohet një herë në pesë vjet, ndërsa përditësimi i tij duhet të bëhet rregullisht

### Si mund ta gjej informacionin që kërkoj në Programin e Transparencës ?



Cilat janë standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankimim? – fusha 3

Çfarë shërbimesh ofron bashkia ime? –Fusha 4

Ku mund të gjej informacion në lidhje me vendimet e këshillit të bashkisë? – fusha 5

Dua të marr pjesë në një konsultim publik mbi projektbuxhetin e bashkisë. Ku mund ti marr vesh afatet dhe vendodhjen ku bëhet konsultimi? Fusha 6

Dua të di më shumë për projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE?- fusha 7

Dua të kem informacion mbi kontratat publike? fusha 4

Cilat janë taksat dhe tarifat vendore? fusha 2



## 2.1 Kategoritë e Informacionit në Programin e Transparencës

Për të rritur aksesin në informacion në nivel vendor, veçanërisht për komunitetet më të varfra, autoritetet vendore duhet të adoptojnë dhe të përditësojnë Programin e Transparencës, i cili duhet të përgatitet sipas formatit standart të aprovuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për t'i bërë më të thjeshtë, të kuptueshëm, të aksesueshëm dhe të përdorshëm të 16 kategoritë e informacionit, të parashikuar shprehimisht në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", janë përshtatur me kontekstin e vetëqeverisjes vendore; me misionin, detyrat, funksionet dhe kompetencat e bashkisë. Në këtë optikë tabela përmbledhëse e Programit është ndarë në 7 fusha kryesore:

.....

**Fusha e parë** Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë është fusha e parë e programit dhe përfshin kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë të përcaktuar nga neni 7 (pika: a; d; g; ç, dh) i ligjit 119/2014. Kjo fushë iu ofron qytetarëve informacion për ndarjen administrativo-territoriale, njësitë administrative përkatëse dhe nën-ndarjet e tyre, për misionin dhe funksionet e bashkisë, për organet e zgjedhura, për administratën e bashkisë, për statistikat vendore, për mekanizmat monitorues dhe të kontrollit si dhe për të drejtën e kërkesës, ankesave dhe vërejtjeve të qytetarëve që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës së bashkisë.

**Fusha e dytë**, e titulluar Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare, është nga fushat më kryesore të Programit dhe përfshin kategoritë e informacionit të përcaktuar nga neni 7 (pika: dh; e; ë) i ligjit 119/2014. Këto kategori informacioni janë përshtatur me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore". Në këtë fushë përfshihen informacione që kanë të bëjnë me planin strategjik të zhvillimit të bashkisë, me programin buxhetor afatmesëm vendor, me paketën fiskale (taksa dhe tarifa), me buxhetin vjetor, me zbatimin, monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e buxhetit, me donacionet si dhe shitjen ose dhënien me qira të pronave dhe aseteve.

Për kërkesat për informim përbën **fushën e tretë** dhe përfshin vendosjen në dispozicion të qytetarëve të informacionit që ka të bëjë me procesin, procedurat, format dhe afatet e kërkesës për informim. Përmbledhja e katër kategorive të informacioni të përcaktuar në nenin 7 (pika c; ç; i; dhe k) të ligjit nr. 119/2014 në një fushë të vetme lehtëson aksesin e qytetarëve për këto kategori informacioni, i orienton dhe udhëzon ato se si mund të bëjnë një kërkesë për informim si dhe u krijon mundësi qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit të vlerësojnë dhe monitorojnë në tërësi këto katër kategori informacioni.

Një nga përgjegjësitë kryesore të bashkisë është ofrimi i shërbimeve publike duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballueshme nga të gjithë grupet e komunitetit. Në këtë kontekst, **fusha e katërt** – Shërbimet Publike - është mbi shërbimet që ofron bashkia dhe përfshin kategoritë e informacionit të përcaktuar në nenin 7 (pika: f; j, ë dhe pjesërisht pika a) të ligjit 119/2014. Nëpërmjet kësaj fushe vihet në dispozicion të qytetarëve informacioni për shërbime publike që ofron bashkia, llojet e shërbimeve, instrumentet e administrimit, kontratat publike, strukturat përgjegjëse, procedurë e ankimimit në lidhje me kontratat publike, standardet, treguesit, procedurat për të përfituar shërbimet si dhe procedurat e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet.

Në hyrje të Kartës Evropiane për Autonominë Vendore përcaktohet se “e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në drejtimin e çështjeve publike bën pjesë në parimet demokratike të përbashkëta”. Kjo e drejtë e qytetarëve mundësohet nga ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe në Program është paraqitur si fushë më vete dhe përfaqëson **fushën e gjashtë** të saj, e cila vendos në dispozicion të qytetarëve informacion në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare.

**Në fushën e shtatë** bashkia vë në dispozicion të qytetarëve informacion të ndryshëm të tillë si: proceset e integritetit evropian (programet dhe projektet); shoqëria civile; raporte, studime dhe vlerësime të ndryshme, veçanërisht ato në lidhje me vlerësimin e transparencës etj; vet-organizimi komunitar.

## **2.2 Procesi i përgatitjes dhe zbatimit të programit të transparencës**

### **Përgatitja**

Procesi i përgatitjes së projekt-programit të transparencës është udhëhequr nga Kryetari i Bashkisë. Në këtë fazë është marrë parasysh Programi modeli i miratuar nga Komisioneri për të

Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (i miratuar me urdhër nr.211 datë 10/09/2018), i cili është përshtatur me specifikat e njësive të vetëqeverisjes vendore me qëllim për të garantuar njohjen maksimale të qytetarëve me informacionin publik nga ana e bashkisë dhe vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion. Janë zhvilluar [...] takime konsultuese me aktorë të shoqërisë civile, medias, biznesit dhe qytetarë për të marrë mendime, sugjerime dhe rekomandime me qëllim që Programi i Transparencës të jetë sa më afër nevojave dhe preferencave të tyre.

### **Miratimi**

Bazuar në nenin 9, 15 dhe 18/3 të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 4 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe në modelin e miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (modeli i miratuar me urdhër nr 121 .datë 10/09/2018, Këshilli bashkiak me vendim nr...., datë...../..... ka miratuar Programin e Transparencës së bashkisë.

### **Publikimi**


Brenda 10 ditëve nga data e miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak, Programi i Transparencës publikohet (i) në faqen zyrtare të internetit të bashkisë ([www.xxxxxxx.gov.al](http://www.xxxxxxx.gov.al)) në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” (linku) (ii) në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë [citen adresat e vendeve].

### **Zbatimi**

Kryetari i bashkisë është përgjegjës për zbatimin e përditshëm të Programit të Transparencës. Në ushtrim të kësaj përgjegjësie, Kryetari i bashkisë me urdhër nr..., datë..../...../201... ka caktuar [emër mbiemër], Koordinator për të drejtën e informimit si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj. Me urdhër nr..., datë..../...../201... ka caktuar [emër mbiemër], Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj. Me urdhër nr..., datë..../...../201.. ka miratuar Rregulloren e Administratës së bashkisë [linku] e cila në nenin ..... ka përcaktuar procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit të faqes zyrtare të internetit të bashkisë për publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës. Në nenin ..... janë përcaktuar procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e çdo strukture të administratës për publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës dhe në nenin .... janë përcaktuar procedurat e trajtimit të kërkesave për informim.

### 3. Strukturat për Informacion dhe Monitorim mbi të drejtën për informim

Monitorimi është një fazë dhe proces mjaft i rëndësishëm i cili ka dy dimensione, atë të vlerësimit dhe të mbikëqyrjes nga institucionet publike dhe nga aktorët jo-publikë.



Programin model.

- **KDIMDP- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMP)** është autoriteti përgjegjës, i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, të drejtën për informim të individëve si dhe shqyrton ankimet administrative.
- **Kryetari i bashkisë** vlerëson dhe mbikëqyr të gjithë procesin e zbatimit të programit të transparencës nga ana e administratës së bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë. Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës do të bëhet jo më pak se njëherë në vit nga ana e këshillit dhe kryetarit të bashkisë nëpërmjet përdorimit të sistemit të matjes që shoqëron

- **Koordinatorët e së drejtës për informim, dhe rastet kur mbajnë përgjegjësi administrative** Në çdo autoritet publik, titullari cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit, detyra e të cilit është mbikëqyrja e përgjigjeve të autoriteteve ndaj kërkesave për informacion. Koordinatori nxit zbatimin e së drejtës për informim në nivel vendor.
- **Këshilli Bashkiak** mbikëqyr informimin e publikut nga ana e bashkisë duke analizuar dhe vlerësuar shkallën e zbatimit të rregullave që ai vetë ka vendosur për këtë qëllim.
- **Aktorët jo-publikë** përfshihen organizatat e shoqërisë civile, media, biznesi, qytetarët dhe grupe të ndryshme interesi, kanë një rol të rëndësishëm si mbikëqyrës dhe monitorues të zbatimit të Programit të Transparencës. Këta aktorë shërbejnë si instrumenta efektiv për të ushtruar “presion” ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore për më shumë llogaridhënie, apo për renditjen e bashkive sipas nivelit të transparencës, duke nxitur në këtë mënyrë konkurrencën mes tyre.





### **3.1 Instrumenti i Vlerësimit së Transparencës Proaktive dhe Reaktive**

Instrumenti i Vlerësimit së Transparencës analizon në total 5 tregues të transparencës në fushën e 7-të të PT-së, me qëllim për të matur dhe raportuar në mënyrë periodike nivelin e transparencës të secilës bashki. Më konkretisht indikatorët që do të vlerësohen janë :

1. Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE
2. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit (të dhëna të ndryshme në lidhje me demografinë e grupeve të interesit apo karakteristikat e tyre psh. OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit, komuniteti Rom dhe Egjiptjan, grupe minoritare, aktor OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit rural.
3. Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit ( kontaktet e tyre)
4. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme
5. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile (projekte apo nisma t OJF-të, ndryshme formale ose informale)

Secili indikator paraqet një dokument apo informacion i cili duhet të publikohet nga bashkitë dhe të jetë lehtësisht i aksesueshëm për qytetarët. Gjithashtu, indikatorët synojnë të masin nivelin e transparencës së bashkive, si dhe shërbejnë për të vlerësuar gatishmërinë e zyrtarëve vendorë për të qenë të hapur ndaj qytetarëve dhe gjithëpërfshirës në vendimmarrje.

Çdo indikator mund të vlerësohet me 0, 1 dhe 2 pikë, në bazë të sasisë dhe cilësisë së informacionit që rezulton në lidhje me të nga monitorimi. Monitoruesi shënon me X vlerësimin përkatës, duke marrë në konsideratë faktin se vlerat që mund të marrin indikatorët janë:


- **Vlerësimi = 0** Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; institucioni nuk kthen përgjigje
- **Vlerësimi = 1** Informacioni është pjesërisht i plotë;
- **Vlerësimi = 2** Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme; informacioni i dërguar është i plotë.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur një ndarje e niveleve të transparencës në 5 grupime të mëdha:

1. transparencë e ulët;
2. transparencë pjesërisht e ulët;
3. transparencë mesatare;
4. transparencë pjesërisht e lartë;
5. transparencë e lartë.

### **3.2 Një sistem i tillë i shërben të gjithë aktorëve, duke filluar nga:**

- *bashkitë*, pasi mundëson evidentimin e pikave të dobta dhe të forta për secilën bashki;
- *Komisionerit*, sepse i vë në dispozicion një instrument të unifikuar monitorimi në përputhje me Programin Model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- aktorëve të tjerë si p.sh. *OSHC-të apo mediave*, të cilët duke monitoruar transparencën e institucioneve me anë të këtij instrumenti, ndikojnë në rritjen e llogaridhënies së bashkive.



### 3.3 Vlerësimi proaktiv

Sipas Urdhërit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Nr.211, datë 10.09.2018 “Për Miratimin e Programit Model të Transparence për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, brenda 10 ditëve nga data e miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak, Programi i Transparencës publikohet (i) në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” (linku)

#### 3.3.1 Programi i Transparencës

Instrumenti i Vlerësimit së Transparencës ka për qëllim të realizojë një vlerësimin objektiv të dokumentacionit që duhet të publikohet në Programin e Transparencës, sipas parashikimeve të nenit 7 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” të grupuar në 5 indikatorë në fushën 7-të të PT-së.

#### 3.3.2 Transparenca online- website, media sociale

Monitorimi i transparencës përfshin edhe vlerësimin e transparencës online, ku vlerësohet transparenca e informacionit të paraqitur në website të bashkive, media sociale. Faqet e internetit, që përfaqësojnë infrastrukturën bazë që mundëson publikimin proaktiv.

#### 3.3.2 Vlerësimit së Transparencës Proaktive përmes publikimit të informacionit në stendën e bashkive

Sipas Urdhërit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Nr.211, datë 10.09.2018 “Për Miratimin e Programit Model të Transparence për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, brenda 10 ditëve nga data e miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak,

Programi i Transparencës publikohet) (ii) në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrativ.

### **3.3.4 Vlerësimi i Transparencës reaktive përmes kërkesave për informim**

Sipas nenit 11 të Ligjit 119/2014, qytetarët kanë të drejtë të informohen dhe përmes kërkesave për informim. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji. 2. Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor. Numri rendor, së bashku me të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepet kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.

Vlerësimi merr përsipër të vlerësojë transparencën në terren apo shkallën e gatishmërisë së bashkisë për të dhënë informacion përmes kërkesave për informim (informimi aktiv). Për një qasje më gjithëpërfshirëse të vlerësimit të transparencës në tërësi, sugjerohet edhe vlerësimi i transparencës reaguese, pasi ajo ofron pamjen më të gjerë dhe të plotë të hapjes së institucionit ndaj publikut.

Më konkretisht, ekspertët hartuan dhe dërguan<sup>14</sup> kërkesa për informim në bashkitëpërkatëse, ku çdo kërkesë përmbante pyetje në lidhje me projektet, nismat dhe të dhënat për shoqërinë civile sipas 5 indikatorëve të përzgjedhur. Kërkesa për informim përmbante informacionin si më poshtë : a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit; b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; c) përshkrimin e informacionit që kërkohet; ç) formatin në të cilin preferohet informacioni; d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.



INSTRUMENTI I  
VLERËSIMIT SË  
TRANSPARENCËS  
PROAKTIVE DHE  
REAKTIVE

Fusha VII Informacion tjetër (10 indikatorë)					
Nënfusha	Indikatori	Vlerësimi			
		Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; V = 0	Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë; V = 1	Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme V = 2	Nr. i pikëve
<b>TRANSPARENCA PROAKTIVE</b>					
1. Bashkia në proceset e integritetit evropian (1 indikator)	1. Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritetit nëBE				
2. Bashkia dhe shoqëria civile (4 indikatorë)	2. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit				
	3. Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit				
	4. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme				
	5. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile				
<b>Totali: Max = 10 pikë</b>					

Fusha VII Informacion tjetër (5 indikatorë)					
Nënfusha	Indikatori	Vlerësimi			
		<i>Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; V = 0</i>	<i>Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë; V = 1</i>	<i>Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme V = 2</i>	Nr. i pikëve
<b>Transparenca proaktive- website dhe media sociale</b>					
1. Bashkia në proceset e integritit evropian (1 indikator)	1. Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritit nëBE				
2. Bashkia dhe shoqëria civile (4 indikatorë)	2. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit				
	3. Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit				
	4. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme				
	5. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile				
<b>Totali: Max = 10 pikë</b>					

Fusha VII Informacion tjetër (5 indikatorë)					
Nënfusha	Indikatori	Vlerësimi			
		<i>Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; V = 0</i>	<i>Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë; V = 1</i>	<i>Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme V = 2</i>	Nr. i pikëve
<b>Transparenca proaktive- stendat</b>					
1. Bashkia në proceset e integritit evropian (1 indikator)	1. Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritit nëBE				
2. Bashkia dhe shoqëria civile (4 indikatorë)	2. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit				
	3. Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit				
	4. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme				
	5. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile				
<b>Totali: Max = 10 pikë</b>					



Fusha VII Informacion tjetër (5 indikatorë)					
Nënfusha	Indikatori	Vlerësimi			
		Nuk ofrohet informacion ose informacioni nuk dërgohet brenda afatit kohor të përcaktuar në legjislacionin (10 ditë); <b>V = 0</b>	Informacioni i i ofruar është pjesërisht i plotë; <b>V = 1</b>	Kategoria e informacionit të ofruar është e plotë dhe e qartë: <b>V = 2</b>	Nr. i pikëve
<b>Transparenca proaktive- Informimi me kërkesë</b>					
1. Bashkia në proceset e integritetit evropian (1 indikator)	1. Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritetit në BE				
2. Bashkia dhe shoqëria civile (4 indikatorë)	2. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit				
	3. Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit				
	4. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme				
	5. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile				
<b>Totali: Max = 10 pikë</b>					

Tabela e pikëzimit

Nr. i pikëve totale	Përqindja	Niveli i transparencës
0-7	0-20%	transparencë e ulët;
8-15	21-40%	transparencë pjesërisht e ulët;
16-23	41-60%	transparencë mesatare;
24-32	61-80%	transparencë pjesërisht e lartë;
33-40	81-100%	transparencë e lartë.